



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 153 prot.

Kamëz, më 17.12.2021

V E N D I M

Nr. 002 Datë 17/12 2021

M B I

“MIRATIMIN E KRITEREVE MBI TRAJTIMIN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR
FAMILJET NË NEVOJË NGA BUXHETI BASHKISË PËR VITIN 2022”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 17.12.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.114 Datë 14.12.2021** në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, nenit 21 të Ligjit nr.nr.57 datë 18/07/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë, Kreut IV të vendimit nr.597 datë 04/09/2019, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, dhe në VKB nr.79 datë 19.07.2021, “Mbi miratimin e Projekt - Buxhetit afat mesëm të Bashkisë Kamëz (PBA)” për vitin 2022,2023,2024, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike, të familjeve në nevojë nga fondet e buxhetit lokal si më poshtë vijon :
 - a) Familje me fëmijë jetim.
 - b) Familje që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme.
 - c) Të moshuar që janë të vetmuar dhe pa kujdestari.
 - d) Familje me persona invalidë dhe kushte shumë të vështira pa të ardhura të tjera.
 - e) Familje me kryefamiljarë në burg dhe fëmijë të vegjël.
 - f) Gra me probleme dhune në familje.
 - g) Familje që kanë probleme të mëdha shëndetësore dhe kërkojnë ndërhyrje të rënda kirurgjikale, si dhe operime jashtë shtetit etj.
 - h) Familje që kanë fatkeqësi njerëzore dhe natyrore.
 - i) Familje që janë të pastreha dhe pa të ardhura.
 - j) Familje që kanë banesë të dëmtuar për arsye madhore.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

